

Data 25 /09 /2025

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: "MIRËMBAJTJE - RIPARIM I SISTEMEVE IMPIANTISTIKE: NGROHJE - FTOHJE - VENTILIMI, FURNIZIM ME UJË, MNZSH NË NDËRTESEN HEC VAU I DEJËS, KOMAN DHE FIERZË", PËR NJË PERIUDHË 3 (TRE) VJEÇARE.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi- 50000000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 81,466,307 (Tetëdhjetë e një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatë) Lek pa TVSH, ose 840,812 (Tetëqind e dyzetmijë e tetë qind e dymbëdhjetë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqiperise në datë 25/ 09/2025 është 96.89 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës" të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar citohet: "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP i ndryshuar "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale : me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës Nr. 10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Duke marrë në konsideratë specifikën e objektit procedure prokurimi, kërkohet që Operatorët Ekonomik ofertues të paraqesin vërtetime të cilat vërtetojnë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar këtë procedure prokurimi në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % vlerës së përlogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ✚ ISO 14001 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- ✚ ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;
- ✚ ISO 50001 “Sistemi i menaxhimit të energjisë” ;

Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate.

ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e risqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” - është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e risqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 50001 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”, është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi., ku të përfshihen të paktën kategoritë e mëposhtme:

- **NS 12 – C** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- **NS 14 – A** Impiante te brendshme , elektrike, telefoni, radiotelefoni etj.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

- **NS 12 - C** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit:

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Kjo pikë licencë është kërkuar pasi Sistemet e ngrohjes-ftohjes-ventilimit (HVAC) janë impiante teknologjike të përmasave industriale ku ndodhin procese termike të ngrohjes, ftohjes dhe qarkullimit të ajrit nga një ambient në një ambient tjetër.

- **NS 14 - A** Impiante te brendshme , elektrike, telefoni, radiotelefoni etj:

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kjo pikë licencë është kërkuar pasi Impiantet e furnizimit me energji elektrike të këtyre sistemeve janë komplekse, të projektuara për të shpërndarë energjinë në mënyrë selektive në të gjithë elementet e sistemit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të kenë në stafin e tij minimalisht :

- ✚ 1 (një) inxhinier mekanik.
- ✚ 1 (një) inxhinier elektronik.
- ✚ 1 (një) inxhinier elektrik.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomat përkatëse;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2025 - Shtator 2025.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të kenë në stafin e tij Specialistët/Teknik të kualifikuar:

- ✚ Minimumi 1 (një) teknik për impiantet ngrohje - ftohje, i pajisur edhe me dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga një organizëm i akredituar në Shqipëri;
- ✚ Minimumi 2 (dy) elektrikiste të pajisur edhe me dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga një organizëm i akredituar në Shqipëri;
- ✚ Minimumi 2 (dy) hidraulike, të pajisur edhe me dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga një organizëm i akredituar në Shqipëri;
- ✚ Minimumi 1 (një) elektromekanik, i pajisur edhe me dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga një organizëm i akredituar në Shqipëri;
- ✚ Minimumi 4 (katër) specialiste ngrohje – ftohje - kondicionim me certifikate trajnimi për këto sisteme;
- ✚ Minimumi 1 (një) specialist për sistemet BMS (sistemi i menaxhimit të ndërtesës);
- ✚ Minimumi 1 (një) specialist për sistemet PLC (programim) dhe AC Drive (panelet komandimi elektrike) me kontroll industrial automatik dhe mekanik;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme.
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2025 - Shtator 2025.
- ✚ Certifikatat përkatëse/dëshmitë e profesioneve.

Shënim: Lejohet që një punonjës mund të ketë më shumë sesa një kualifikim/ trajnim, sipas kriterit teknik 2.3.5.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Kërkesa teknike që OE të ketë në stafin e tij inxhinieret dhe stafin e kualifikuar është një kërkesë në përputhje

me objektin e kontratës pasi proceset e zbatimit të projektit, referuar kërkesave teknike të përcaktuara në specifikimet teknike janë specifike dhe kërkojnë një nivel të lartë inxhinierik dhe profesional.

Kjo procedurë prokurimi, gjatë zbatimit të kontratës kërkon nivel të lartë profesional dhe kryerjen e proceseve inxhinierike të zbatimit të projektit për të garantuar cilësi dhe siguri të lartë në realizimin me sukses të shërbimeve në përputhje me specifikimet teknike dhe zërat e pritshëm që duhet të realizohen në kohe.

Konkretisht, Inxhinierët dhe specialistet e kualifikuar janë kërkuar pasi:

Stafi inxhinierik i kërkuar si më sipër është i nevojshëm për zbatimin me sukses të procedurës së kërkuar sipas kërkesave dhe natyrës specifike të këtyre impianteve për secilin Hidrocentral ku janë të instaluar ato.

Ndërthurja e këtyre sistemeve me njëra tjetrën për të krijuar një sistem të tere kompleks (impiant industrial/teknologjik) është dhe pjesa më e rëndësishme e tij për shkak të implementimit dhe bashkëveprimit të shumë pajisjeve mekanike, elektrike dhe elektronike së bashku. Kjo është dhe arsyeja që stafi inxhinierik i kërkuar të ketë eksperience në punime të tilla të ngjashme mbi riparimet dhe mirëmbajtjen e këtyre impianteve industriale/teknologjike, për të shfaqur aftësi dhe mundësi profesionale për zbatimin me sukses të procedurës së kërkuar nga AK.

Specialistet/tekniket e kërkuar si më sipër janë të nevojshëm për zbatimin me sukses të procedurës së kërkuar sipas kërkesave dhe natyrës specifike të mirëmbajtjes së këtyre impianteve për secilin Hidrocentral ku janë të instaluar ato. Numri minimal i kërkuar të specialisteve/teknikeve ato janë kërkuar sipas një logjike profesionale mbi zbatimin me sukses të mirëmbajtjes së këtyre sistemeve, duke patur parasysh se këto sisteme janë të instaluar në tre Hidrocentrale të ndryshme (Hec Fierze, Koman dhe Vau i Dejës) dhe një natyrë e tillë punimesh për zbatimin e mirëmbajtjes së kërkuar kur objektet apo kantieret e punës janë me distancë të konsiderueshme me njëra tjetrën, kërkon një staf minimal mirëmbajtës të gatishmërisë teknike i cili është domosdoshmëri për të përmbushur me sukses nevojat e mirëmbajtjes së kërkuar në çfarëdo lloji situatë teknike e paraqitur në HEC-ce të ndryshme ku ato janë të instaluar.

Sistemi impiantistik siç është HVAC është një ndërthurje impiantesh mekanike, elektrike dhe elektronike. Impiantet mekanike janë ato më kryesoret ku ndodhin proceset e shkëmbimit të nxehtësisë për të ngrohur ose ftohur ajrin/ujin dhe qarkullimin e ajrit/ujit të ngrohtë ose të ftohtë në ambiente të ndryshme të shpërndara sipas godinave të centraleve të HEC-ve ku janë të instaluar.

I gjithë sistemi operon në mënyrë automatike, ku komandohet nëpërmjet një njësie qendrore të kompjuterizuar dhe paketa elektronike etj. Njësia qendrore e kontrollit është e programuar sipas logjikës së operimit të sistemit në fjalë dhe komandon të gjithë proceset. Impianti Elektrik shërben për të furnizuar njësitë chiller dhe nevojat vetjake të sistemit siç janë pompat, ventilatorët dhe të gjithë pajisjet e tjera elektrike përfshirë edhe njësitë qendrore të operimit.

Për të mirëmbajtur këto sisteme duhet një staf inxhinierik dhe teknik të fushës të specializuar për këto sisteme, që të njohin teknologjitë që përdoren dhe operimin e këtyre impianteve mekanike, elektrike, elektronike të ndërthurura së-bashku.

Sistemi i furnizimi me ujë dhe MNZSH janë ndërthurje impiantesh hidraulike dhe mekanike të instaluar në ambientet e godinave të centraleve të HEC-ve dhe njohja e këtyre sistemeve kërkon njohuritë dhe specialistin/et e fushës përkatëse.

Sistemet ne fjale janë te instaluar ne godina te impianteve te prodhimit te energjise elektrike (centraleve te HEC-ve), ku ka prezence te tenseoneve te mesme dhe te larta dhe stafi teknik qe do te punojë direkt ne objekt, duhet te jetë i njohur me impiantet me prezencë tensioni, pra duhet te jene pajisur edhe me dëshmi kualifikimi sigurimi teknik për te punuar ne ambiente te tilla.

Përveç kontrollit dhe vlerësimit të mjedisit të brendshëm të ndërtesës, sistemet BMS shpesh here lidhen me kontrollin e hyrjes (kthesat dhe dyert e hyrjes që kontrollojnë ku lejohet hyrja dhe dalja në ndërtesë) ose sisteme të tjera të sigurisë siç është televizioni me qark të mbyllur (CCTV) dhe detektorët e lëvizjes.

Kalibrojnë dhe konfigurojnë objektivat ne sistemet CCTV, sistemet e alarmit, ndryshimi i baterive dhe parametrave. Sistemet e alarmit të zjarrit dhe ashensorët gjithashtu lidhen ndonjëherë me një BMS për monitorim. Në rast se zbulohet një zjarr, atëherë vetëm paneli i alarmit të zjarrit mund të mbyllë amortizatorët në sistemin e ventilimit për të ndaluar përhapjen e tymit, të mbyllë mbajtësit e ajrit, të fillojë aspiratorët e evakuimit të tymit dhe të dërgojë të gjithë ashensorët në katin përdhes dhe t'i parkojë ato për të parandaluar njerëzit duke i përdorur ato.

Sistemet impianistike të HEC-ve si ato të ngrohje-ftohjes e të gjitha në tërësi kanë motorë elektrike me frekuencë të ndryshueshme ose inverter. Një pjese e mire e energjisë për nevojat e brendshme të HEC-ve shkon në këtë drejtim, prandaj kërkohet që operatori ofertues të ketë specialist të kualifikuar sepse në varësi të modelit, parametrat e funksionimit të VFD (motor me frekuencë të ndryshueshme) mund të programohen nëpërmjet: programeve të dedikuara të programimit, tastierës së brendshme, tastierës së jashtme ose kartës SD. VFD -të shpesh do të bllokojnë shumicën e ndryshimeve të programimit gjatë ekzekutimit. Parametrat tipikë që duhet të vendosen përfshijnë: informacionin e pllakës së motorit, burimin e referencës së shpejtësisë, burimin e kontrollit on/off dhe kontrollin e frenimit etj. Është gjithashtu e zakonshme që VFD -të të japin informacion të korigjimit siç janë kodet e defekteve dhe gjendjet e sinjaleve hyrëse dhe specialistet te kenë eksperience ne ndryshimin parametrash, leximin e tyre dhe riparimin e qarqeve te sigurisë etj.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje janë të certifikuara (CE).

Argumentimi:

Ky kriter është kërkuar në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike mbi certifikimin CE të gjitha materialeve që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje e cila vërteton dhe garanton AK për përputhshmërinë e një produkti me standardet specifike dhe normat, si dhe garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky kriter është kërkuar në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, si dhe garanton AK se OE merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendrike të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të provojë mundësinë e disponimit, të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve, si më poshtë:

Nr.	Lloji i makinerisë , pajisjes, mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Automjete transporti (ATP/ATM)	copë	4	Në pronësi ose me qira
2	Matës gazi	copë	3	Në pronësi ose me qira
3	Indikator gazi	copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Set saldimi + saldatrice	kompet	1	Në pronësi ose me qira
5	Prese elektrike per presim tubash	copë	1	Në pronësi ose me qira

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

a) Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen e makinerive dhe pajisjeve:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose fatura e blerjes ose dokument zhdoganimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- Kontratë huapërdorje.

b) Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen e automjeteve:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje.

Leje qarkullimi e mjetit.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Të gjithë këto makineri dhe pajisje janë përcaktuar në përkatësi me natyrën e objektit të prokurimit dhe që të përdoren gjatë zbatimit të kësaj procedure prokurimi.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumente.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë se Kontraktuesi i mirëmbajtjes do të kryejë shërbimet riparim-mirëmbajtëse të duhura dhe të preventiv ara si dhe zëvendësimin e pjesëve të ndërrimit në sasi dhe cilësi për të garantuar funksionim normal të sistemeve të ngrohjes-ftohjes në mënyrë që të krijohen kushte sa më të mira pune për personelin e Njësive Prodhuese në funksion të detyrave që ata kryejnë për mbarëvajtjen e punëve në HEC-e.
- Njëkohësisht kërkohet të arrihet qëllimi për plotësimin e kërkesave për Eficiencë Energjitike dhe krijimi i “praktikave më të mira” të përdorimit me efikasitet të energjisë në të gjitha ambientet e brendshme të sallës së komandës dhe ambienteve përreth saj.
- Në kuadrin e “praktikave më të mira” si detyrë primare përcaktohet investigimi i performancës energjitike dhe mjedisore të ndërtesës, me qëllimin e përcaktimit të ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin e kushteve të punës brenda standardeve të përcaktuara të komfortit për ambientet e brendshme të punës. Për çdo ndërhyrje të nevojshme merret dakordësia e përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor apo specialistëve të lartë sipas fushave përkatëse (mekanike, elektrike, elektronike etj.).
- Gjithashtu pjesë e objektivit të përgjithshëm është përmirësimi i kushteve të komfortit të ambienteve të brendshme të punës në sallën e komandës të Njësive të Prodhimit të HEC-ve në përputhje me standardet mjedisore dhe shëndetësore të përcaktuara nga ligji. Ky objektivi ka lidhje me politikën e përgjegjësisë sociale dhe mjedisore që ndjek KESH sh.a.

Ky prokurim nuk rekomandohet ne ndahet ne lote pasi:

Bazuar në natyrën e këtij shërbimi dhe faktin që është një shërbim i njëjtë për Njësitë e Prodhimit Hec Fierzë, Hec Koman dhe Hec Vau i Dejës, na nevojitet një operator i cili të njohë mirë objektet të cilat do të mirëmbahen dhe të mbajë përgjegjësi të plotë mbi mbarëvajtjen e kontratës.

Bazuar në marrëveshjen Kuadër që do të lidhet me OE të suksesshëm, Autoriteti kontraktor do të lidhë (mini) kontrata sipas nevojave për të arritur të funksionojnë normalisht të gjitha sistemet impiantistike nëpërmjet kryerjes së shërbimeve teknike të programuara dhe riparimeve të nevojshme. Do të kërkohet realizimi i të gjithë shërbimeve të parashikuara si dhe riparimet e nevojshme.

Operatori Ekonomik (OE) i mirëmbajtjes do të kryejë shërbimet riparim-mirëmbajtëse të duhura dhe të preventivuar si dhe zëvendësimin e pjesëve të ndërrimit në sasi dhe cilësi për të garantuar funksionim normal brenda konditave teknike të sistemeve të ngrohjes-ftohjes në mënyrë që të krijohen kushte normale pune për personelin e Njësive Prodhuese në funksion të detyrave që ata kryejnë për mbarëvajtjen e punëve në HEC-e.

Lloji i procedurës: Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar –Shërbime – Mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik, ku të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

Kjo lloj marrëveshje është e bazuar në,

- Nenin 52 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,
- Nenin 61, neni 64 dhe 65 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Marrëveshja kuadër do të aplikohet me një operator të vetëm ekonomik, me qëllim lidhjen e kontratave të bazuara në këtë marrëveshje, brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Lidhja e marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik është më e përshtatshme duke patur parasysh natyrën e shërbimeve mirëmbajtëse, riparimeve ma apo pa zëvendësimin e pjesëve/nyjeve të sistemeve teknike dhe specifikimeve teknike, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Bazuar në marrëveshjen Kuadër, Autoriteti kontraktor do të lidhë (mini) kontrata sipas nevojave për të arritur të funksionojnë normalisht të gjitha sistemet impiantistike nëpërmjet kryerjes së shërbimeve teknike të programuara dhe riparimeve të nevojshme.

Njësia e Prokurimit